

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	
	Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 14, 15 dhe 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 97 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim i përkohshëm në Pronat e Regullorës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, si dhe në bazë të kërkesës përrishqyrtim 05 Nr. 350/02-118697/20 dt. 15.07.2020, të pronares Ima Hasani, rr."27 Nëntori", Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore përhartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin Zhvillimor Urban - PZHU, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 08.09.2020, merr këtë:

V E N D I M **PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR NDËRTESË TË PËRKOHSHME**

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronares Ima Hasani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-118697/20 dt. 15.07.2020, përhartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor për Urban - PZHU, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale me nr. 44-36, ZK Orlloviq.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU, i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës me 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Ndërtim individual".

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelëave kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit i parcelës kadastrale, është:
- nr. 44-36, me S= 2580 m², me pronare Ima Hasani, "arë e klasës 3";
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale me nr. 44-36, nuk ka ndërtesa të ndërtuar;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerësi nga drejtimi veri-perëndimi në jug-lindje, me disniveli ~5.0m', por që një pjesë e terrenit është e gërmuar;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është përmes rrugës ekzistuese;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa banimi;

IV. Kushtet ndërtimore përhartimin e dokumentacionit ndërtimor-projetit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin e ndërtimit të ndërtesës së përkohshme me destinim përafazëm, përservisim të automjeteve, në kuadër të Planit Rregullues Urban – PZHU, Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kompleks, pozicionimi, gabariti dhe etazhitë i ndërtesave të përkohshme, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës si dhe ndërtesat e tjera, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera



për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “zgjidhja urbane”, bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- ndërtimore;
 - Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohet ndërtesa e përkohshme me destinim afarizëm – depo, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:
 - ndërtesa, me $S=412.5 \text{ m}^2$; etazhiteti: P+0; destinimi: afarizëm - depo;
 - Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas rregullores për ndërtimin e ndërtesave të përkohshme, të jetë për "afarizëm";
 - Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas Regullorës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, është P+0;
 - Koeficienti i shfrytëzimit maksimal (ISHP), të parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese sipas Regullorës 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, për vendosjen e ndërtesave në bazë - gabarit në përdhesë, është max. 40 %, dhe kjo sipërfaqe për këtë parcelës, duhet të jetë:
 - Parcela ndërtimore, nr. 44-36, ZK Prishtinë, ka sipërfaqe prej $S=2580.0 \text{ m}^2$, nga kjo sipërfaqja prej $S=2059.0 \text{ m}^2$, është brenda vijës rregulluese.

$S=2059.0 \times 0.4=823.6 \text{ m}^2$ / e lejuar sipas Rregullores,
 $S=429.0 \text{ m}^2$ /sipas projekt propozimit;
 - Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISGJ) është min 40%, Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me gjelbërim të lartë dhe të ulët, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:
 $S=2059.0 \times 0.4=823.6 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës,
 $S=1009.4 \text{ m}^2$ /sipas projekt propozimit;
 - Bazuar në Regulloren për Procedurat e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt: 31.12.2014, neni 11, përcakton se distanca e ndërtesave me karakter të përkohshëm nga kufiri i parcelës, përcaktohet sipas kritereve të planeve urbanistike. Sipas kësaj rregullore distanca mund të zvogëlohet deri në 1.2m, me pëlgim të pronarëve ose edhe mund të eliminohet tërësisht. Ndërsa sipas Planit Zhvillimor Urban, distanca më e vogël nga kufiri i parcelës është 0.5-0.75H, ku H është lartësia e objektit;
 - Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe eficiencës së energjisë, që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore, ndërsa për distanca nga kufiri i parcelës dhe ISHP të ndërtesës, të llogaritet shtresa finale e fasadës së ndërtesës;
 - Qasja në kompleks të jetë nga rruga ekzistuese, e cila është dhe rrugë e planifikuar për zgjerim;
 - Parkimi i jashtëm të planifikohet brenda vijës rregulluese;
 - Numri i vendparkingjeve sipas Planit Zhvillimor Urban – PZHU, për sipërfaqe me destinim afarizëm duhet të llogaritet $1\text{VP}/30\text{m}^2$;
 - Objekti me karakter të përkohshëm për të cilin lëshohet leja ndërtimore, është objekt i ri – montazh, që përveç themelit, mund të jetë i ndërtuar nga druri, metali, plastika apo materiali tjeter i ngjashëm dhe që është lehtë i demolueshëm.
 - Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
 - Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuar;
 - Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. Para aplikimit për leje ndërtimore, aplikuesit duhet:

V. Para apkimit per reje komunitare i Kushtet teknike nga KOST-i apo KEDS-i (varësisht nga tensioni i 1. Të sigurojnë *Kushtet teknike* nga **KOST-i** apo **KEDS-i** (varësisht nga tensioni i largpërçuesve), për ndërtimin e ndërtesës së planifikuar, objekt i përkohshëm me asfazizëm – depo,

në kuadër të parcelës kadastrale nr. 44-36 ZK Orlloviq, përgjatë parcelës me shtrirje veri-jug, kalojnë largpërçuesit e tensionit të lartë;

2. Të zhvillojnë procedurën e ndërrimit të llojit të shfrytëzimit të parcelave kadastrale – rrugëve të planifikuara brenda parcelës, dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrin kadastral me destinim “infrastrukturë – rrugë”, bazuar në situacionin e bashkëngjitur me vendimin e caktimit të kushteve ndërtimore;

VI. Deklarata e pronarit – në bazë të pikës 2. të Nenit 12, të Regullorës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt. 31.12.2014, me kërkesën për leje ndërtimi, duhet të prezantohet deklarata e pronarit të parcelës e vërtetuar te organi kompetent, me anë të cilës deklaron se pronari do ta largoj objektin vet brenda (8) tetë dite, pas shfuqizimit të lejes ndërtimore.

VII. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).
- Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrithinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesen e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe paralogaritë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;

- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kerkuesve (bashkëpronarëve të parcelave);

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor - projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Arsyimet

Pronare Ima Hasani nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 350/02-118697/20 dt. 15.07.2020, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës së përkohshme me destinim afarizëm - depo, në lokacionin e përshkruar në paragrin 1. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronarja ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 44-36, ZK Orlloviq;
- Projektin konceptual - projektin ideor dhe Planin e situacionit - "zgjidha urbane" të ndërtesës së përkohshme me destinim afarizëm – depo, të hartuar nga "ZH - STUDIO" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, rr. "Enver Maloku", me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810056813;
- Shkresën "Informatën nga Plani Zhvillimor Urban - PZHU", me referencë: 04-350/01-260258/19 dt. 07.06.2019, të datës 06.11.2019;
- Incizimi gjeodezik, punuar nga Muzafer Mustafa, gjeodet i licencuar me nr. të licencës 09;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore në emër të Maliq Hasani, sipas kërkesës së Ima Hasani, me nr.118645/20 (21952932) dt.15.07.2020;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të pronares;

Faqë 4 prej 6

• Foto nga terreni.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën me 05 Nr. 350/02-118697/20 dt. 15.07.2020, për caktimin e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektin ideor, për ndërtimin e ndërtuesës së përkohshme me destinim afarizëm - depo.

Pas kontrollimit të projektit konceptual nga përgjegjësi për komunikacion i kësaj drejtorie, i njëjtë ka konstatuar si në vijim: "Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Ima Hasani, në fshatin Shkabaj, Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-118697/20 të dt. 15.07.2020, kyçja për automjete në rrugët ekzistuese, e cila rrugë është e tē pranohen si e till. Në fazat e ardhshme të projektit të realizimit të ndërtuesave afariste për rrugët qarkulluese vend parkime, duhet të aplikohen kriteret – dimensionet sipas "Normave teknike planifikimit hapësinor", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m, dhe varësisht nga gjerësia e rrugëve kaluese dhe rrezet e lakesave – kthesave duhet ti plotësojnë kushtet teknike të tyre planifikimi referente. Gjithashtu duhet të sigurohet trotuari për këmbësor me gjerësi minimale prej 1.5m nga rruga e planifikuar deri tek hyrja në ndërtesë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo."

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për lokacionin në fjalë, Rregullativët ligjore në fuqi, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr. 01.nr. 110-288305 dt: 31.12.2014, si dhe duke u bazuar në projektin konceptual i prezantuar - dokumentacioni i dorëzuar, është në harmoni me UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 / kriteret e Rregullores në fuqi, andaj, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, të MMPH-së, ka vendosur njoftimin me datë 22.06.2020-27.06.2020. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë (10.08.2020-14.08.2020). Gjatë kohës së njoftimit publik është pranuar një ankesë nga një banor i lagjës, sipas së cilët infrastruktura e lagjes është vetinvestim i banorëve dhe se nuk lejojnë qasjen e aplikueses në infrastrukturë, gjegjësisht në rrjet të ujësjellësit dhe elektrik. Drejtoria e Urbanizmit, përmes shkresës zyrtare "Informim" me referencë 05 Nr. 350/02-118697/20 dt. 15.07.2020 të datës 25.08.2020, njofton palen në lidhur me ankesën e tij, si në vijim: "- Bazuar në kërkesën e palës, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektin ideor, për ndërtimin e objektit të përkohshëm afarist - depo, trajtimi i kërkesës bëhet parcelën kadastrale është rrugë e asfaltuar; - Drejtoria e Urbanizmit, me aktin administrativ – Vendim për kushte ndërtimore, të cilin e lëshon, në kapitull të veçantë "Kyçja në infrastrukturë" kërkon nga pala marrjen e pëlqimeve në KEDS dhe KUR Prishtina, për vazhdim të proceduarave përmarrjen e Lejes së ndërtimit".

Drejtoria e Urbanizmit, ka konstatuar që janë plotësuar kushtet për të vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, rregullativët ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkuesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projektin konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Zhvillimor Urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrëthinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.


Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane".

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dërgohet: Kërkuesit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-118697/20 DT. 08.09.2020**

Zyrtar:
Liridon Gashi


U.D. Udhëheqëse e sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi

